

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:REHABILITIM I PARKUT

BIBLIOTEKA E QYTETIT TE

BERATIT

MARS 2026

RELACION TEKNIK

Për rehabilitimin e parkut Biblioteka e Qytetit të Beratit

1. Qëllimi i projektit

Qëllimi i këtij projekti është rehabilitimi dhe përmirësimi funksional i një pjese të sheshit publik në zonën pranë bibliotekës në qytetin e Berat. Ndërhyrja synon rikthimin e parametrave funksionalë të shtresës së shtrimit, përmirësimin e kushteve të përdorimit nga këmbësorët dhe rritjen e cilësisë estetike të hapësirës urbane.

Projekti parashikon ndërhyrje të pjesshme në shtresën ekzistuese të pllakave të betonit, stabilizimin e nënshtresës dhe vendosjen e elementeve të mobilimit urban.

2. Gjendja ekzistuese

Nga verifikimi në terren dhe analiza vizuale e sheshit rezulton se sipërfaqja ekzistuese është e shtruar me pllaka betoni, të cilat në disa zona paraqesin:

- dëmtime strukturore dhe mekanike,
- çarje dhe konsumim të materialit,
- zhvendosje ose ulje të pllakave për shkak të degradimit të nënshtresës,
- deformime të pjesshme të sipërfaqes së shtrimit.

Këto probleme ndikojnë negativisht në funksionalitetin e hapësirës, në komoditetin e lëvizjes së këmbësorëve dhe në pamjen estetike të sheshit.

3. Përshkrimi i ndërhyrjes së projektuar

Ndërhyrja konsiston në rehabilitimin e pjesshëm të shtresës së shtrimit dhe përmirësimin e mobilimit urban të sheshit.

3.1 Çmontimi i shtresës ekzistuese

Punimet fillojnë me çmontimin dhe largimin e pjesshëm të pllakave ekzistuese të betonit në zonat ku konstatohet degradim i shtresës së shtrimit.

Materialet e larguara do të transportohen dhe depozitohen në vendet e përcaktuara sipas rregullave për menaxhimin e mbetjeve të ndërtimit.

3.2 Përgatitja dhe stabilizimi i nënshtresës

Pas largimit të pllakave ekzistuese do të kryhet përgatitja e sipërfaqes mbajtëse. Në këtë fazë parashikohen këto punime:

- pastrimi dhe nivelimi i terrenit,
- vendosja e shtresës stabilizuese (stabilizant),
- kompaktimi mekanik i shtresës për të arritur densitetin e kërkuar.

Kjo shtresë do të shërbejë si bazë mbajtëse për vendosjen e shtresës përfundimtare të shtrimit.

3.3 Vendosja e shtresës së re të shtrimit

Në zonat e rehabilituara parashikohet vendosja e pllakave të reja prej betoni për përdorim në hapësira publike.

Vendosja e pllakave do të realizohet mbi një shtresë rëre ose stabilizanti të përgatitur paraprakisht, duke siguruar:

- nivelim të rregullt të sipërfaqes,
- qëndrueshmëri strukturore të shtresës së shtrimit,
- drenazh të përshtatshëm të ujërave sipërfaqësore.

Ndërhyrja nuk përfshin të gjithë sipërfaqen e sheshit, por vetëm zonat e identifikuara për rehabilitim.

4. Mobilimi urban

Në kuadër të përmirësimit të funksionalitetit dhe komoditetit të hapësirës publike parashikohet vendosja e elementeve të mobilimit urban.

Elementet e projektuar përfshijnë:

Stola dekorativë metalikë

Stolat do të realizohen me strukturë metalike rezistente ndaj korrozionit dhe të përshtatshme për përdorim në hapësira publike. Vendosja e tyre do të realizohet në mënyrë të shpërndarë për të krijuar zona pushimi për përdoruesit e sheshit.

Ndriçues urbanë me shtylla

Parashikohet vendosja e ndriçuesve publikë me shtylla metalike, të cilët do të kontribuojnë në përmirësimin e ndriçimit gjatë orëve të mbrëmjes dhe në rritjen e sigurisë së hapësirës.

Kosha për mbeturina

Do të vendosen kosha metalikë për mbeturina në pika të përshtatshme të sheshit, me qëllim ruajtjen e pastërtisë dhe menaxhimin më të mirë të mbetjeve urbane.

5. Materialet dhe standardet

Materialet që do të përdoren në realizimin e punimeve do të jenë në përputhje me standardet teknike të ndërtimit dhe normativat në fuqi për hapësirat publike urbane.

Do të përdoren materiale me rezistencë të lartë ndaj:

- ngarkesave të përdorimit publik,
 - faktorëve atmosferikë,
 - konsumimit nga përdorimi i përditshëm.
-

6. Përfundime

Rehabilitimi i pjesshëm i sheshit pranë bibliotekës në Berat do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë funksionale dhe estetike të kësaj hapësire publike. Ndërhyrja do të kontribuojë në krijimin e një ambienti më të sigurt, më të organizuar dhe më të përshtatshëm për përdorimin nga komuniteti.

Punimet do të realizohen duke respektuar kërkesat teknike të projektit dhe standardet e ndërtimit për hapësirat urbane.

Pergatiti: Ing. Besjana Kokoshi

Arch. Frenci Ceca

Ing. Anxhelo Dhimo